UDHËZIM
Nr. 15, datë 18.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 19 "Transaksionet e ndërmjetësve", pas pikës 4.1 shtohet pika 4.1/1 me këtë përmbajtje:

"4.1/1. Operatorët kryesorë të telekomuni-kacionit mund të zgjedhin të aplikojnë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, me anë të distributorëve /furnizuesve të ndërmjetëm, duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm.

Operatori kryesor që zgjedh të aplikojë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, duhet paraprakisht të depozitojë në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse një deklaratë me shkrim, sipas së cilës të shprehet zgjedhja e dëshiruar. Kjo deklaratë duhet të përmbajë veç të tjerash, listën e distributorëve/furnizuesve të ndërmjetëm.

Në rast se operatori kryesor zgjedh të aplikojë zbritjen direkt në faturë, për vlerën e ndërhyrjes në treg, duhet ta bëjë këtë për të gjithë distributorët/furnizuesit e tij të ndërmjetëm dhe për një periudhë jo më pak se 12 muaj të njëpasnjëshëm. Gjithashtu, nëse operatori kryesor heq dorë nga zgjedhja me qëllim që të aplikojë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, siç parashikohet në pikën 4.1 më lart, atëherë ai duhet të njoftojë paraprakisht organin tatimor.

Edhe në këtë rast operatorët kryesorë llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave të parapaguara, ose të kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit, që ata u furnizojnë distributorëve/ndërmjetësve të tyre. Operatori kryesor zbret direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë furnizuesit e mëvonshëm pa ndikuar TVSH-në e llogaritur, si më lart.

Furnizimi i këtyre kartave, ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave nga distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm në furnizimet e mëtejshme nuk është objekt i aplikimit të TVSH-së, pasi TVSH është aplikuar për çmimin përfundimtar nga operatori kryesor që furnizon shërbimin e telekomunikacionit, por në çdo rast furnizimi tek furnizuesit e ndërmjetëm bëhet duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg, pa llogaritur TVSH. Distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm nuk kanë të drejtë të zbresin vlerën e TVSH-së së faturuar nga operatorët kryesorë për furnizimin e kryer, përsa ata nuk kanë të drejtë të aplikojnë TVSH për furnizimet e mëtejshme të kryera në fazat pasardhëse.

Për qëllime dokumentimi të çdo transaksioni që kryejnë në fazat pasardhëse për shitjen e kartave/kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit, distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm duhet të lëshojnë faturë tatimore pa llogaritur TVSH, në të cilën çmimi i këtij furnizimi është i barabartë me çmimin përfundimtar (përfshirë TVSH-në) për konsumatorin final, të faturuar prej operatorit kryesor në momentin e furnizimit të këtyre produkteve. Po kështu në çdo faturë të lëshuar në furnizimet e mëtejshme nga distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm do të zbritet vlera e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse.

Shembull: Supozojmë që operatori kryesor i telekomunikacionit "X" hedh në treg karta telefonike me çmim me pakicë për konsumatorin final të barabartë me 1.000 lekë (përfshirë TVSH). Kjo shoqëri do të lëshojë një faturë ku TVSH e llogaritur do të jetë:

833.4+166.6(TVSH)=1.000 lekë. TVSH-ja deklarohet dhe paguhet normalisht nga Operatori kryesor "X". *Po në këtë faturë Operatori kryesor i telekomunikacionit "X"* zbret vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, p.sh. 150 lekë, pa ndikuar në TVSH-në e llogaritur si më sipër. Pra fatura e lëshuar nga Operatori kryesor "X" për distributorin/furnizuesin e ndërmjetëm "Y" do të paraqitet:

Përshkrimi i mallit ose shërbimit	Vlera pa t.v.sh.	t.v.sh.	Vlera me t.v.sh.
Kartë e parapaguar	*833.4*	*166.6*	*1.000 lekë*
Zbritje për ndërhyrjen në treg	*(150)*	-	*(150)lekë*
Totali	*683.4*	*166.6*	*850 lekë*

Shoqëria distributore/furnizuese e ndërmjetme "Y" që blen kartën me faturën e mësipërme, nuk llogarit më TVSH në rishitjen e kësaj karte dhe nuk ka të drejtë të zbresë 166.6 lekë TVSH të faturës së lëshuar nga operatori kryesor.

Distributori/furnizuesi i ndërmjetëm i regjistron në librin e blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së faturën e blerjes së kartave si "blerje pa TVSH" dhe faturën e shitjes së tyre si "shitje pa TVSH".

Qarkullimi i distributorit/furnizuesit të ndërmjetëm në përputhje me nenin 119 të ligjit llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi (konsumator final) për shërbimet e mësipërme.

2. Në nenin 45 "Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimet e përjashtuara", pas fjalisë së dytë me përmbajtjen "*Kjo e drejtë është e kufizuar ……*" , shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

"*Gjithashtu, pavarësisht nga trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH i furnizimit (shitjes) të ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese, i parashikuar në nenin 53, pika g) të ligjit, personi i tatueshëm që furnizon ndërtesën ose pjesë të një ndërtese, gëzon të drejtën e zgjedhjes për ta trajtuar këtë furnizim si furnizim të tatueshëm me TVSH 20%.*

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ ".

3. Në nenin 55 "Kufizime të zbritjes së TVSH-së për disa furnizime", pas fjalisë me përmbajtjen, "*Me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-në…..*sipas veprimtarive", shtohen fjalitë me përmbajtjen si më poshtë:

"*Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjeti/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proçes të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuara sipas veprimeve te realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim*".

4. Në nenin 64 "Proçedura e rimbursimit dhe përjashtimit për diplomatët, organizatat ndërkombëtare, NATO", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Në pikën 2, në fjalinë që fillon me togfjalëshin "Për blerjet brenda vendit" hiqet togfjalëshi me përmbajtjen:

"*me kusht që çdo faturë blerjeje të jetë më e madhe se 10.000 lekë*"

b. Pika e dytë e numërtuar "2" që fillon me fjalinë "*Përsa u përket blerjeve që personeli i NATO-s dhe bazat e saj bëjnë brenda vendit….*", numërtohet pika "3"

5. Në nenin 66 "Faturimi" bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Në fund të pikës "4" shtohet fjalia me përmbajtjen:

"*Personi i tatueshëm lejohet të përdorë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve, sipas kushteve dhe procedurës të përcaktuara për këtë qëllim në ligjin dhe udhëzimin "Për*

procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b. Pika "5", hiqet.

c. Pika "6" numërtohet si pika "5".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj